



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____ .08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: objekt “*Mirembajtje e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore, TAIS* (Marreveshje Kuader me një operator ekonomik fitues, ku të gjitha kushtet janë të percaktuara, me afat 24 muaj)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

8000000-8– Paketa software dhe sisteme informacion;

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 999 999.92 (*nje milion e nenteqind e nentehjete e nente mije e nenteqind e nentehjete e nente presje nentehjete e dy*) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier (njësia e prokurimit) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,

si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas percaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **600 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që

garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkojë në Procedurën e Hapur e Thjeshtuar, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe në Ligjin nr.29/2023 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përpjeshtje me vlerën e fondit limit të parashikuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë *dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit*. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **300 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet-), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vertetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët Ekonomik duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me një ent publik, si dëshmi pranohen:

-Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, ose vetëm Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I përfundimit të kontratës, ose vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 41, pika 3 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **300 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,

prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij për të paktën 3 muajt e fundit (muajt -prill -maj-qershor 2026) listpagesë personelin me kapacitetet teknike të mëposhtme:

- a) Te pakten 2 (dy) specialistë (me diploma të shkollës së lartë) të çertifikuar Analist Biznesi Software (*Software Business Analyst*) në platformën Microsoft Dynamics, në të cilën është bazuar sistemi i implementimit.
- b) Te pakten 2 (dy) specialiste të informatikës ekonomike (me diplome të shkolles së lartë)
- c) Te pakten 2 (dy) specialistë të çertifikuar: 1 (një) për menaxhimin e shërbimeve IT si ITIL (me diploma të shkollës së lartë në degët e teknologjisë së informacioni), dhe 1 (një) prej specialistëve për testime të sistemit software, ose ekuivalente.
- ç) 1 (një) specialist të çertifikuar si zhvillues .

Për specialistet e sipërcituar duhet të paraqiten:

- a) diplome universitare,
- b) dëshmi/certifikimet ose çdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimet e tyre,
- c) kontrate individuale të punës të vlefshme
- d) listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **3 muajt e fundit** (muajt -prill -maj-qershor 2026).

Shënim: Për pikën 2.3.2 me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesat e punonjësve të trajnuar për Mirembajtje të Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore, TAIS, lidhet me nevojën për mirembajtje të sistemeve të taksave, si dhe lidhet ngushtë me

specifikimet teknike të shërbimit të kërkuara, referuar natyrës dhe rëndësisë që mbart kjo procedurë për Autoriteti Kontraktor. Nëpërmjet punonjeseve të mesipër, operatori ekonomik siguron autoritetin kontraktor për realizimin e suksesshëm të procedurës dhe garantohet për aftësinë e punonjesit që do të kryejë mirëmbajtjen e sistemit të taksave, si dhe dëshmojnë se kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e objekti të prokurimit. Gjithashtu nisur nga argumentimi i grupit të punës për hartimin e kriterëve të vecanta që lidhen me kapacitetin teknik ka argumentuar se nisur nga afati i përcaktuar i shërbimit është gjykuar se është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës 2 specialistë të cilët do të analizojnë kërkesat për shërbimin sipas përcaktimeve në terma të referencës. Gjithashtu për të mos patur ndërprerje të shërbimit të kërkuar prej tyre janë kërkuar 2 punonjes të cilët mund të shërbejnë dhe si back up (plotësues) i njëri tjetrit. Për punonjesit e përcaktuar (në pikën 2.3.2 germa C) argumentohet nga grupi i punës për hartimin e kriterëve të vecanta që lidhen me kapacitetin teknik se këta punonjes kerkohen për të siguruar që konfigurimet e kërkuara të realizohen në cilësi të duhur dhe sistemi TAIS të ofroj funksionalitetet e tij pa problematika si dhe për të ekzekutuar sipas standarteve ndërkombëtare të ofrimit të shërbimeve në fushën IT.

Për punonjesit e përcaktuar (në pikën 2.3.2 germa ç) 1 (një) specialist të certifikuar si zhvillues argumentohet nga grupi i punës për hartimin e kriterëve të vecanta që lidhen me kapacitetin teknik se këta punonjes kerkohen për të siguruar që konfigurimet apo zhvillimet që mund të kerkohen të kryhen në sistem, të kryhen me cilësinë e duhur teknike, është e domosdoshme që OE të ketë në dispozicion për realizimin e kontratës një specialist zhvillues i certifikuar për gjuhë programimi.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Statusin e Ofruesit të shërbimit nga prodhuesi Microsoft për platformën mbi të cilën është bazuar zgjidhja ekzistuese për menaxhimin e taksave, konkretisht Microsoft Dynamics NAV 2013.

Argumentimi: Ky kriter i përcaktuar në pikën a) dhe b) është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimi, nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/ certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te ndryshuar.*

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet Teknike për procedurën e prokurimit janë hartuar nga Grupi i Punes i ngritur me Urdher te Titullarit AK te Autorizuar me Nr.8741 Prot date 03.07.2026, “Mbi ngritjen e grupit te Punes per hartimin dhe argumentimin e termave te references, kerkesave te vecante per kualifikim, testimin e tregut dhe perlllogaritjen e fondit limit, per proceduren: **“Mirembajtje e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore, TAIS**, i cili ka hartuar dhe argumentuar specifikimet teknike, termat e references dhe përlllogaritjen e fondit limit, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 41, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e vecanta te kualifikimit qe lidhen me kapacitetin teknik jane hartuar nga Grupi i Punes i ngritur me Urdher te Titullarit AK te Autorizuar me nr. Nr.8741 Prot date 03.07.2026, ne baze te materialit te ardhur me nr. 9986/1 prot. dt. 03.08.2026.

Specifikimet teknike dhe termat e references gjenden bashkengjitur DST ne SPE.

Referimet ku në termat e references/specifikimet teknike janë përmendur marka / produkte / origjinë, shoqërohen me fjalën “ose ekuivalente”.

Njësia e prokurimit: